



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 688 prot

Roskovec, më 30 / 01 /2026

VENDIM

NR 4 .DATË 29.01 .2026

**“PËR MIRATIM TË PROJEKTEVE PRIORITARE INFRASTRUKTURE PËR
BASHKINË ROSKOVEC PËR VITIN 2026”**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”i ndryshuar, neni 54, shkronja k); Ligjit Nr.8743, datë 31.07.2000 për “Pronat e paluajtshme të shtetit” (i ndryshuar); Ligjit Nr. 8744, datë 22.02.2001 për “Transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore” (i ndryshuar); Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 500, datë 14.08.2001 për “Inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin në njësitë e qeverisjes vendore” (i ndryshuar), Udhëzimit të Ministrit të Pushtetit Vendor nr. 3, datë 18.07.2002 për “Inventarizimin e pronave të paluajtshme të shtetit nga njësitë e qeverisjes vendore”, Këshilli i Bashkisë,

VENDOSI :

1. Miratimin e projekteve prioritare të cilat kanë nevojë për ndërhyrje emergjente, si më poshtë :

Bashkia Roskovec , Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, gjatë verifikimeve në terren në periudha të ndryshme të vitit 2025, projekteve të parealizuara në vitet e mëparshme por që janë të rëndësishme për zhvillimin e territorit, si edhe projekt ideve dhe vizionit për të ardhmen ka nxjerrë listën e projekteve prioritare. Projektet janë bazuar nga nevojat emergjente të fatkeqsive natyrore, nevojat emergjente të restaurimeve të godinave arsimore, projekteve inovatore të energjisë së rinovueshme, menaxhimit të mbetjeve dhe projektet e pyllëzimit-gjelbërimit si edhe rikualifikimit urban.

Projekte Infrastruktura:

- 1- Ndërtimi i unazës Perëndimore (e cila ka 3 nënobjekte)**
 - Ndërtimi i tregut agro-ushqimor
 - Terminali i autobusave ndërqytetas
 - Rrugët lidhëse
- 2- Marrja e masave për transferimin e banorëve të zonës së shkarjes Mbërs.**
- 3- Ndërhyrje emergjente në njësinë administrative Kurjan**
- 4- “Rikonstruksion i objektit ekzistues të shkollës 9 –vjeçare “Ali Sollaku” dhe i ambjenteve sportive, Ndërtimi i shkollëve të emergjencës dhe Godina e Re e Palestrës së kësaj shkolle” në fshatin Vidhisht, Bashkia Roskovec”.**
- 5- Ndërtimi i kopshtit të përqëndruar për fëmijë në Njësinë Administrative Strum**
- 6- Restaurimi i godinës së çerdhes Jagodinë, dhe zyrës së pleqësisë**
- 7- Roskoveci Qarkullues, zgjidhje të reja për riciklim dhe ndarje në burim**
- 8- Përmirësimi i st. pompimit Suk Arapaj dhe përmirësimi i rrjetit kullues**
- 9- Ndërtimi i bibliotekës së re të qytetit.**
- 10- Restaurimi i shkollës fillore “Rahmen Dashi” Arapaj**
- 11- Stabilmenbt-Linje zinxhir që nga grumbullimi deri te ambalazhimi dhe krijimi i Brand-it, "Vaji i Ullirit Roskovec"**
- 12- Rritja e sigurisë së argjenaturës përgjat “lumit Seman”**
- 13- Rikonstruksioni i ujësjellësit të Njësisë Administrative Kuman**
- 14- Ndërtimi i rrjetit KUZ , njësia Administrative Kuman**
- 15- Ndërtim i ujësjellësit të fshatit Ngjeqar, Njësia Administrative Kurjan.**
- 16- Rikualifikim urban i qendrave të fshatrave.**
- 17- Restaurimi i shtresave Asfaltike në rrugët e Njësisë Administrative Kurjan**
- 18- Restaurimi i shtresave Asfaltike në rrugët e Njësisë Administrative Kuman**
- 19- Restaurimi i shtresave Asfaltike në rrugët e Njësisë Administrative Strum**
- 20- Restaurimi i shtresave Asfaltike në rrugët e qytetit Roskovec**
- 21- Sistemi fotovoltaiik për vetkonsum në stacionet e pompimit Metushaj, Jagodinë.**
- 22- Sistem fotovoltaiik për ngrohje në godinat e arsimit parauniversitar.**
- 23- Rijetëzim i ambjenteve sportive në territorin e Bashkisë Roskovec.**
- 24- Linjë përpunimi të perimeve të fushës dhe përpunim i produktit ndryshe.**
- 25- Përmirësimi i ujitjes në fshatin Suk 1,**
- 26- Rehabilitimi i përroit të Vidhishtës (përgjat fshatit),**
- 27- Rivitalizimi i pyllit të Luarit dhe parkut rekreativ**
- 28- Krijimi i shtegut i bicikletave**
- 29- Rikonstruksioni total i kishës së Shën Gjergjit (Monument kulture)**
- 30- Pyllëzimin e liqenit të Kurjanit**
- 31- Pyllëzimi i brezit të gjelbër, Suk-Jagodinë- Marinëz.**

32- Krijimi i parkut zero karbon.

2. Ngarkohet Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Mjedisit dhe Pronës për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETAR
Afrim Plaka





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 689 Prot.

Roskovec, më 30.01 2026

V E N D I M

NR 5 , DATË 29.01 .2026

PËR

“PËR MIRATIM FONDESH SHITESË NË BUXHETIN E BASHKISË ROSKOVEC PËR VITIN 2026”

Në mbështetje të ligjit Nr.139/2015 “Per vetëqeverisjen vendore“ i ndryshuar, neni 54 pika dh , të ligjit Nr.68/2017 “Për financat e vetëqeverisjen vendore“ neni 46 , të ligjit Nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH” i ndryshuar neni 47 , të udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë Nr.9 datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, të VKB Nr. 71 datë 24.12.2025 “Për miratimin e dokumentit përfundimtar të PBA 2026-2028 dhe buxhetit të vitit 2026”, shkresës së Ministrisë së Financave me Nr.18133/1 prot., datë 24.12.2025 ,si dhe materialeve të sjellë nga Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit,Mjedisit dhe Pronës dhe nga Drejtoria e Shërbimit Social; Këshilli i Bashkisë,

-VENDOSI :

I. Të miratohet fondi shtesë i akorduar për bashkinë Roskovec prej **37,625,541** lekë si transfert e pakushtëzuar e përgjithshme dhe akordim nga fondi rezervë për njësitë e vetëqeverisjes vendore për vitin 2025,për shlyerje detyrimesh të prapambetura sipas përcaktimeve në aktin normativ dhe në shkresën përkatëse.

Shtohet:

1. NJËSIA SHPENZUESE "BASHKIA ROSKOVEC", KODI 2113001

•	Gr.00	TIT. 01110	KAP. 01	ART. 602	14,073,775	lekë
•	Gr.00	TIT. 09120	KAP. 01	ART. 602	2,479,174	lekë
•	Gr.00	TIT. 08220	KAP. 01	ART. 602	97,200	lekë
•	Gr.00	TIT. 10430	KAP. 01	ART. 602	976,392	lekë
•	Gr.00	TIT. 04520	KAP. 01	ART. 231	20,000,000	lekë

TOTAL 37,625,541 lekë

II. Të miratohet fondi shtesë i akorduar për bashkinë Roskovec prej **1,023,000** lekë nga Fondi Social për vitin 2026:

Shtohet:

2. NJËSIA SHPENZUESE "BASHKIA ROSKOVEC", KODI 2113001

-	Gr.13	TIT. 10430	KAP. 01	ART. 606	1,023,000	lekë
---	-------	------------	---------	----------	------------------	-------------

III. Të miratojë alokimin e fondeve të përfituara nga Granti i Bazuar në Performancë (GBP) për Bashkinë Roskovec për vitin 2025, me burim financimi nga Buxheti i Shtetit, sipas vendimit përfundimtarë të Komisionit të Vlerësimit të Aplikimeve, në vlerën totale **5,828,911.82** lekë, për “Restaurimi i shkollës në fshatin Arapaj” me qëllim përmirësimin e kushteve të mësimdhënies dhe sigurisë së nxënësve. Vlera e plotë e projektit është **9,828,912 lekë me TVSH**, nga e cila 40.69% financohet nga Bashkia Roskovec konkretisht **4,000,000 lekë** e miratuar me VKB Nr. 71 datë 24.12.2025 “Për miratimin e dokumentit përfundimtar të PBA 2026-2028 dhe buxhetit të vitit 2026” dhe 59.3% do të financohet nga Buxheti i Shtetit me vlerë **5,828,911.82 lekë**.
Fondet e miratuara sipas pikës 3 të këtij vendimi të reflektohen në buxhetin e Bashkisë për vitin 2026, në programet përkatës si më poshtë.

Shtohet:

3. NJËSIA SHPENZUESE "BASHKIA ROSKOVEC", KODI 2113001

• Gr.00 TIT. 09120 KAP. 01 ART. 231 **5,828,911.82 lekë**

IV. Ngarkohet struktura përgjegjëse e Administratës së Bashkisë për zbatimin e këtij vendimi.

V. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETAR

Afrim Plaka

